



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2 të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, të dispozitave të nenit 16, paragrafi 2 të Rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, nr. 01-011/02-187748/19, dt. 01.08.2019, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2019, miratoi këtë

VENDIM
PËR MIRATIMIN E ÇMIMORES PËR PARKINGJET PUBLIKE TË KOMUNËS SË
PRISHTINËS

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për miratimin e çmimores për parkingjet publike të komunës së Prishtinës.

Neni 2

Shumat e propozuara nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit për parkingjet publike, janë të cekura në çmimoren e cekur në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është çmimorja për parkingjet e menaxhuara nga "Prishtina Parking".

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-352/13-315051/19, më 30.12.2019

KRYESUES I KUVENDIT

Agim Kuleta

